



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 711/8 prot.

Datë 14.04.2025

V E N D I M
Nr. 490/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergji Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-35374-01-15-2025, me objekt: “Loti II: “Blerje materiale për “Art dhe Zeje”, me fond limit 25,935,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.02.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara

Ankimues:

Operatori ekonomik “AN&RA” SHPK me NIPT K12205001I dhe adresë: Rruga Barrikada , Hyrja 3, Apartamenti 10, Ish Kinema 17 Nentori, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, Sh.A.
Adresa: “Rruga: “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik ”InfoSoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16.01.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar,” me nr. REF-35374-01-15-2025, me objekt:

“Loti II: “Blerje materiale për “Art dhe Zeje”, me fond limit 25,935,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 17.02.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 17.02.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 27.02.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Ervin Luzi P.F.	18,843,300 lekë	Skualifikuar
InfoSoft Office SHPK	19,451,500 lekë	Kualifikuar
AN&RA SHPK	19,774,595 lekë	Kualifikuar
GENTIAN HORIETI P.F	19,957,800 lekë	Skualifikuar
Naim Hysi P.F.	20,038,460 lekë	Skualifikuar
MALBERTEX SHPK	24,015,912 lekë	Skualifikuar
LIBRARI DYRRAHU SHPK	24,500,000 lekë	Kualifikuar
ARTEO 2018 SHPK	25,296,000 lekë	Kualifikuar
FILARA SHPK	Pa ofertë ekonomike	Skualifikuar

II.4. Në datën 06.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 13.03.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5133 dhe me nr. protokolli 711/2025, datë 13.03.2025, e operatorit ekonomik “AN&RA” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 711/1 datë 17.03.2025, lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “AN&RA” SHPK, mbi shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike autoriteti kontraktor ka përcjellë vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr.245/8 prot., datë 17.03.2025, protokolluar me tonën me nr.711/2 prot., datë 18.03.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues

“AN&Ra” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj me arsyetimin si më poshtë: “...**Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konkludon se kjo ankesë konsiderohet si e paparaqitur, pasi konstatohet kushtet e mëposhtme:**

1. Mospërmbushje e aspekti formal dhe kushteve ligjore-pasi konstatohet mungesa e pagesës së tarifës për ligjërimin e kësaj anese dhe në këtë kontekst, formulari i ankesës nuk është paraqitur në mënyrën e duhur pasi nuk është bashkëlidhur mandati i pagesës së plotë.

2. Përfundimi i afatit për korrigjim- duke qenë se operatorit ekonomik ankimues i është vënë afati 2 ditë në dispozicion për kryejn e tarifës së pagesës përkatëse për t'i dhënë mundësinë e korrigjimit dhe ky i fundit nuk ka arritur të dëshmojë pagesën e vlerës së plotë, ky afat konsiderohet i përfunduar.

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave e konsideron ankesën si të paparaqitur”.

Bashkëngjitur vendimi të KSHA autoriteti kontraktor ka përcjellë dhe komunikimin e bërë me operatorin ekonomik ankimues “AN&RA” SHPK nëpërmjet postës elektronike, lidhur me plotësimin e të metave të ankesës që në rastin konkret kanë të bëjnë me pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

II.8. Vendimin e KSHA nr.245/8 prot., datë 17.03.2025, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar, vendim i cili është protokolluar me tonën me nr.711/3 prot., datë 19.03.2025.

II.9. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike në datën 24.03.2025 operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, ka paraqitur formularin e paraqitjes se argumentave si subjekt i interesuar në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, formular i cili është protokolluar me tonën me nr.711/4 prot., datë 25.03.2025. Në datën 25.03.2025 të njëjtin formular operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK e ka dorëzuar përsëri në SAE, formular i cili është protokolluar me tonën me nr.711/5 prot., datë 25.03.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, vlen të theksojmë se, për sa i përket pretendimit të autoritetit kontraktor të paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik se **Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave e konsideron ankesën si të paparaqitur** me arsyetimin se: “[...]”Në zbatim të detyrimeve ligjore të sipërcituara, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave e ka shqyrtuar ankesën nga pikëpamja formale dhe ka konstatuar se rezultoni e paplotë pasi nuk është bashkëlidhur dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Në datë 13.03.2025, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vuri në dijeni ankimuesin për plotësimin e mangësisë së konstatuar, për të kryer pagesën e tarifës dhe dorëzimin e mandatit. Gjithashtu, për kryerjen e këtij veprimi nga ana e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave përcaktoi edhe afatin sipas parashikimeve të predispozitave ligjore, duke kërkuar korrigjimin brenda 2 ditëve nga marrja e njoftimit. Në datë 15.03.2025 që përkon edhe me përfundimin e afatit, operatori ekonomik ankimues “AN&RA” shpk kryen pagesën e tarifës e cila rezulton me një diferencë nga shuma e duhur, pra e paplotë dhe referuar Komisionit të Prokurimit Publik, statusi i mandat pagesës rezulton i pa paguar. Për sa më sipër, duke qenë se pagesa e tarifës nuk është bërë në shumën e plotë të kërkuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave e vlerëson këtë ankesë si të paparaqitur. Duke qenë se ka përfunduar afati i vënë në dispozicion për kryerjen e korrigjimeve, i parashikuar, nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik, KSHA konstaton se nuk është kryer pagesa e saktë dhe e plotë.

...Pra, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konkludon se kjo ankesë konsiderohet si e paparaqitur, pasi konstatohen kushtet e mëposhtme;

1.Mospërmbushje e aspekti formal dhe kushteve ligjore-pasi konstatohet mungesa e pagesës së tarifës për ligjërimin e kësaj ankese dhe në këtë kontekst, formulari i ankesës nuk është paraqitur në mënyrën e duhur pasi nuk është bashkëlidhur mandati i pagesës së plotë

2.Përfundimi i afatit për korrigjim- duke qenë se operatorit ekonomik ankimues i është vënë afati 2 ditor në dispozicion për kryerjen e tarifës së pagesës përkatëse për t'i dhënë mundësinë e korrigjimit dhe ky i fundit nuk ka arritur të dëshmojë pagesën e vlerës së plotë, ky afat konsiderohet i përfunduar.

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave e konsideron ankesën si të paparaqitur” [...]/, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1.Në nenin 111”Paraqitja e ankesës” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. **Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.**

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.2. Në nenin 56 “Llogaritja e afateve” të K.Pr Administrative parashikohet shprehimisht se: “ 1. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, afatet caktohen në ditë, muaj ose vite. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike. 2. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati. 3. Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. 4. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. **Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj**

III.1.3. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimese, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës nr.245/9 prot., datë 18.03.2025, protokolluar me tonën nr. 711/3 prot., datë 19.03.2025, rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, sepse përmes komunikimit elektronik i ka kërkuar operatorit ekonomik “An&RA” SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, që në rastin konkret konsistojnë në kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Rezulton se në datën **13.03.2025** KSHA ka njoftuar operatorin ekonomik ankimes për plotësimin e mangësisë së konstatuar, kryerjen e pagesës dhe dorëzimin e mandatit, duke i lënë një afat 2 ditor, pra datën **15.03.2025**. Duke qenë se data 15.03.2025, data e lënë për korrigjimin e të metave bie ditë e shtunë, referuar pikë 4 të nenit 56 të K.Pr. Administrative, kjo datë shtyhet për ditën pasardhëse të punës, pra datën **17.03.2025**. KPP vëren se operatori ekonomik ankimes ka kryer pagesën në datën 15.03.2025, pagesë e cila nuk është në vlerën e përcaktuar dhe diferencën për tarifën e plotë të ankesës në datën **17.03.2025**, pra brenda afatit të përcaktuar. Sa më sipër arsyetuar Komisioni gjykon se ankimesi ka korrigjuar të metat e ankesës brenda afatit ligjor të përcaktuar,

e për rrjedhojë ankesa konsiderohet e paraqitur në afat e për rrjedhojë Komisioni do të vijojë me shqyrtimin në themel të saj.

III.2.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “An&RA” SHPK, për mospërbushje të kriterit 2.3.1 nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me pretendimin se: “Nuk ploteson kapacitetet teknike 40% kontrata te ngjashme per 4 grupe artikujt, nga 5 grup artikuj qe jane objekte prokurimi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në shtojcën 8 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.3.1, pjesë e dokumenteve të tenderit, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ndërsa, në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” është parashikuar si më poshtë:

LOTI II: “BLERJE MATERIALE PËR “ART DHE ZEJE”

Nr.	Emërtimi	Specifikime Teknike	Njësia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
	Zeje - Arte Tradicionale					
1	Bobina e fijeve të peshkut	Bobina 250gr, fije lino,	kg	218	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

2	Bobina me fije pambuku	Bobina 250gr, fije Pambuku, nr.50	kg	261	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
3	Fije akriliku	artizan, 1 turre 100 gr/ fije akriliku per shtiza	kg	395	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
4	Shtiza	artizan, / spear-loom (artizan shtize tezgjah)	copë	198	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
5	Kornizë druri për tezgjah	artizan, / spear-loom (artizan shtize tezgjah 30 cm me 49 cm) druri	copë	81	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
6	Gërshërë	artizan/tailoring base/ rrobaqepsie)	copë	211	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
7	Ngjitës	Bobina silikonit shoqeruar me ngrohës për perpunimin e silikonit mekanik	copë	134	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
8	Copa për çanta në metra	artizan/tailoring base/ rrobaqepsie) dendësia 200gr/m2	copë	583	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
9	Rrotulla letre të bardhë	Leter e bardhë, tabak	copë	1637	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
10	Gjilpëra dore	Plastike dhe metalike, për përdorim individual për fëmijë	copë	140	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
11	Tezgjah	Te vogla për trajnime individuale përmasa 30x40 cm/ kompesate e presuar që mban brenda kreherin ngjeshës dhe gjilpërë druri për fijen e thurjes	copë	107	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
12	Fije pambuku	Nr.50 me bobina të pershtateshme për tezgjah/ bobina 250 gr.	kg	645	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
13	Copa prej linoje në metra	Lino me 70 % pambuk/ dendësia 200 gr/m2	copë	332	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

14	Tavoline qëndisje	Cope e printuar dizajn perkates per qendisje// cope lino e printuar me bojra eco product	copë	255	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
15	Fjongo me ngjyra të ndryshme	Fjongo me gjerësi 3 cm pelhure sintetike// artizan// embroiderer	metër	1104	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
16	Korniza për qëndisje dhe piktura	Gjergjef druri i pershtatur per te mirembajtur copat qe punohen	copë	270	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
17	Dru specifik	Binar bredhi i pa planuar 7.5x7.5 cm x3m/ Binar pishe i planuar 6.5x12.5 cm x 3.6m	copë	7	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
18	Kallupe	Kallupe dru pishe, bredhi	copë	5	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
19	Sharrë me zinxhir	Motosharre me zinxhir 1800ë, me lame 40cm	copë	7	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
20	Dalta	Dalte druri e drejte, 25 mm	copë	6	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
21	Letër zumpare	Rrjete zmerile grit, 180, 5pc, 280x93 mm	copë	7	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
22	Bojë vaji	Boje vaji me shkelqim, metal/dru/0.75 lit. mbulon 10 m2/liter.	copë	6	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
23	Llak	Llak i perdorshem per instrumenta	copë	7	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
24	Vegla të tjera për punën	Morsa shtrenguese//sharre hekuri e vogel, sharre druri dore 18", çelik, //sopate dore 1.5 kg, çelik 80 x 20 cm //Sqepar me doreze	copë	6	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

		druri 450 gr //Pincë universale krom-0 vanadium 160 mm// Set me kaçavida FX tools, 6 cope //çekiç per karpantiere, çelik, doreze druri, 300 gram//Set me lima çelik 6 copë.				
--	--	---	--	--	--	--

	Pikturë-Art figurativ					
25	Bojera vaji	Boje vaji me tubeta ose ekuivalent me gramatura te ndryshme, pigmente me perzierje vaj lini, minimum 25 ml, 6 cope	set	895	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
26	Lapsa pastel	Bojera dhjami vajore/dyllore, trashesia minimum 6mm, seti =24 cope	set	872	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
27	Leter vizatimi	Pako me 24 flete disenjo, minimumi 220 miligram	pako	232	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
28	Telajo	Kornize druri, e mbeshjtjelle me kanavace, permasa 30cm x40 cm (druri 20mm x 40mm)	copë	1,055	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
29	Bojera uji/ 15 pc	ngjyra me tubeta te tretshme ne uje, sti minimumi 12 cope	pako	785	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
30	Lapsa me ngjyra te tretshme ne uje /15 pc	Akuarele ne forme lapsi, minimum 12 cope per set	set	749	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
31	Boje akriliku	me tubeta minimum 12 copë	set	929	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

32	Tavaloz	Material druri qe vendoset ne parakrahe nga nxenesit per te perzier bojrat per pikturen, ovale, dimensionimi minimum 20cm x 30 cm. Ideal per perzierien e bojrave gjate pikturimit.	copë	531	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
33	Tavaloz	Material plastik qe vendoset ne parakrahe nga nxenesit per te perzier bojrat per pikturen, dimensionimi minimum 20cm x 30 cm. Ideal per perzierien e bojrave gjate pikturimit.	copë	515	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
34	Penela te dimensioneve te ndryshme	Set penela boje, 24 cope/set	set	779	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
35	Kavalete	Kavalete tavoline te vogla qe vendosen mbi tavolina.	copë	802	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
36	Gome	Gome e bute	copë	1,020	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
37	Set lapsa grafike	perzierje grafiti me pluhur argjili me nr. te ndryshem, minimumi 6 cope	pako	902	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
38	Lapsa karboni	Perzierje qymyri e grafiti	copë	1,035	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
39	Plasteline	Plasteline me kuti, minimumi 500 gram	copë	999	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
40	Argjile	Balte minerale-argjile ngjyre gri	copë	910	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

41	Vaj lini	200 ml, per tretjen e bojerave te vajit	kg	58	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
TEATËR						
PAKETA 1- Mosha 8-10 vjec						
42	Grim per personazhet e teatrit	Aquacolor me 3 nuanca	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
		Penela minimum 3	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
		Eye Shadoë e zeze	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
		Eye Shadoë Glitter	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
		Manual per Grim per moshat 8-10 vjec	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
Totali i paketës			Pakete	31		
PAKETA 2 - Mosha 10-13 vjec						
43	Grim per personazhet e teatrit	Aqua Color e kuqe	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
		Aqua color e zeze	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
		Aqua Color e bardhe	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
		Penel, minimumi 3	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
		HD/ Blood (gjak artificial i cili perdoret per te krijuar efektin e gjakut)	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
Totali i paketës			Pakete	43		
PAKETA 3 - Mosha 14-18 vjec						

44	Grim per personazhet e teatrit	Liquid latex	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
		Aqua color hair mascara	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
		fresh scratch	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
		penel	Copë		IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
Totali i paketës			Pakete	46		

	Kor					
45	Fustan per vajza, per korin	Material zhars ose ekuivalent; perdoret material i lehte, me fije medafshi, ose ekuivalent, qe derdhet, me permasa sipas kerkesave te AK	Copë	206	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
46	Pantallona e kemishe per djem per korin	Material doku, ose ekuivalent i bute, kambrik ose ekuivalent, me kopsa, perdoret dok i holle, ose ekuivalent dhe i bute per pantallonat dhe puplin e holle ose ekuivalent per kemishat	Copë/ komplet	174	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
47	Kepuce te zeza per korin vajza	Lekure e bute, ose ekuivalent me material te lehte	palë	206	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
48	Kepuce te zeza per korin djem	Lekure e bute, ose ekuivalent, elastik dhe lidhese, me material te lehte.	palë	174	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

	“Muzikë – Vegla muzikore”					
49	Kitare klasike	Pjesa e sipërme: Bredh, Baack@Anet: Meranti (Shorea macrophyllia), qafa: Nato, Derrase: Palisander (Dalbergia latifolia), Ura: Palisander (Dalbergia latifolia), Gjeresia e arres: 52 mm, Thellesia e trupit: 43- 100 mm, 650 mm (25,59”), Ngjyra: Natyrale me shkelqim te larte	copë	61	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
50	Metronom digjital	24 variacione rrahjesh per praktikimin e rrahjeve te thjeshta ose komplekse, 9 Ritme, Prekni butonin tempo per te rregulluar shpejt tempin ose per te analizuar ritmin e kenges, Ekran i madh LCD me shume informacione dhe metronom me rezolucion te larte plus 2 LED, Funkcioni i zerit: Dalja e gjysmetoneve nepermjet, i vogel, i lehte, i dobishem dhe i qendrueshem, dizajne shume i sheshte per shkak te baterise se litiumit CR2302, Lidhja per nje kufje	copë	18	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

		stereo, funksioni i fikjes automatike", kapese per stenden e muzikes dhe foleja per nje monedhe... Gama e ritmit 30-250 bpm				
51	Sintonizues elektronik	Modalitet kromatike dhe strobe plus 109-LED, Ekran per performancen e Akordimit Ultimate	copë	32	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
52	Daulle (Perkusion)	Instrument Muzikor me goditje per te gjitha kategorite e niveleve	copë	18	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
53	Tela per kitare klasike (me voltazh te larte)	6 cope tela per kitare klasike, 4 perberje bronzi, 2 me perberje Metal Bronzi	Set	97	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër
54	Set celesash per kitare	Model AE - 016 JP	set	71	IAP	12 muaj marrëveshje kuadër

Vendi i dorëzimit të mallit: Sipas Aneksit Nr. 2

Afatet e lëvrimit: Kohëzgjatja - afati i lëvrimit të mallit është 40 (dyzet) ditë nga data e nënshkrimit të mini-kontratës përkatëse

III.2.2. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik "Infosoft Office" SHPK ka ngarkuar:

1. Dokumentin me emërtimin "*Fatura_compressed*",

III.2.3. Në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.4. Në nenin 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore³⁷, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara”

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët

ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për furnizimeve të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë, në një vlerë jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit dhe që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar shtojcës 7 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mallrat objekt - prokurimi dhe sasi të respektive të tyre. KPP gjykon, se në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit, lidhet me blerjen e materialeve për art dhe zeje ku përfshihen artikuj për arte dhe zeje tradicionale, artikuj për pikturë dhe art figurativ, artikuj për kor (Fustan per vajza, per korin, Pantallona e kemishe per djem per korin) artikuj për vegla muzikore etj.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”* KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmive për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra, ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes, ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të

kontraës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontraëts, me një vlerë jo më pak se 40 % e vlerës së kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

Lidhur me faktin nëse faturat tatimore të dorëzuara nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK plotësojnë apo jo kriterin kualifikues të furnizimeve të ngjashme, KPP do t’i analizojë në 3 (tre) komponentë kumulative dhe konkretisht komponenti i vlefshmërisë, komponenti i ngjashmërisë dhe komponenti i vlerës së realizuar. Për sa i përket vlefshmërisë së faturave të dorëzuara, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se faturat e paraqitura janë të vlefshme për efekt të përmbushjes së kriterit kualifikues të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi. Lidhur me komponentin e ngjashmërisë, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të shitjes, të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, KPP konstaton, se me anë të faturave tatimore të dorëzuara nuk dëshmon, se ka kryer furnizime të natyrës së shitjes së mallrave objekt – prokurimi, por dëshmon se ka kryer furnizime të natyrës së mallrave kancelari. KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre faturave, rezulton, se këto fatura nuk konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, pra operatori ekonomik nuk ka arritur që të dorëzojë dëshmi që ka realizuar furnizime të ngjashme. Lidhur me komponentin e vlerës, vlera e faturave të paraqitura është ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Sa më sipër, KPP vlerëson, se faturat tatimore të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues nuk plotësojnë të tre komponentët kumulativ në interpretim të kriterit kualifikues. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “InfoSoft Office ” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “AN&RA” SHPK, se operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK se: *“Per me teper dhe ne Ekstraktin e Subjektit, InfoSoft Office, mungon objekti i veprimtarise pergrup artikuajt e pikes c, Kori”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “a” e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

[...]

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

III.3.2. Në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit , në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

III.3.3. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK rezulton, se është paraqitur:

-Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 9

III.3.4. Neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” i VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se:

“Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Këto kritere synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”

III.3.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.6. Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për 14 përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të

gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.3.8. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për sa i përket objektit të veprimtarisë së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në fjalë rezulton, se në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në Pjesën II, “*Shkaqet e përjashtimit*”, gërma “A” “*Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit*”, është deklaruar si më poshtë:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Në adresën e ueb-it: [https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/] Autoritetin ose organin lëshues: [Qendra Kombëtare e Biznesit] Lloji i dokumentit: [EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Në adresën e ueb-it: [https://e-albania.al]

Gjithashtu, nga verifikimi i Ekstraktit historik të regjistrit për të dhënat e subjektit “Infosoft Office” SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton, se objekti i aktivitetit është përcaktuar: “*Import eksport dhe tregtim të artikujve kancelarik, konsumablave etj. Krijim paketa programesh për fusha të ndryshme, animacion i kompjuterizuar dhe shërbime të tjera softëare. Studime, informime, keshillime për probleme të informatikes, të drejtimit ekonomik financiar dhe administrimit për ndermarrje, banka, institucione etj. Import eksport sistemesh për perpunimin e të dhenave, grupe vazhdueshmerie periferike, pajisje dhe mobilje për zyra e të tjera për rregullimin e zyrave me celesta në dore. Asistence teknike, riparime, instalime dhe konfigurime të sistemeve të perpunimit të të dhenave, grupe vazhdueshmerie periferike. Perfaqesim ndermjetesim, lidhje kontratash në emer dhe për llogari të firmave të tjera, vendase*

ose te huaja. Operacione tregtare komisionere. Veprime Faktoring (kreditime) dhe Leasing (blerje te kushtezuara). Import-eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice te mallrave industriale, ushqimore dhe te tjera. Zbatues i punimeve, projektues dhe kolaudues ne fushen e ndertimit. Import-eksport dhe tregti letre te formateve te ndryshme. Prodhim dhe tregti shtypshkrimesh, letre printeri te vazhduar dhe logimesh te ndryshme. Prodhim kuti dhe dosje per arkive, etj. Veprimtari te dhenies me qira te pasurive te paluajteshme. Ofrues te sherbimeve te printimit, qeradhenie dhe tregtim te pajisjeve te printimit dhe hardëare, menaxhim te sistemeve te printimit Pay Per Use dhe Pay Per Print, krijim dhe mirembajte rrjetesh 2 kompjuterike, informatike, dhe elektronike, import eksport dhe tregtim te konsumablave per pajisje te ndryshme, tonerave, lodrave, etj. Menaxhim i shoqerive tregtare. Konsulence juridike dhe perfaqesim ne institucione shteterore ne fushen civile penale, tregtare dhe administrative. Konsulence financiare. Konsulence dhe sherbime prokurimi. Administrim i logjistikes dhe magazinimit te produkteve. Transport mallrash per vete dhe te trete. Çdo veprimtari tjeter te ligjshme ne territorin e Republikes se Shqiperise. ”. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar formulari i pergjithshëm i vetëdeklarimit, lidhur me objektin e veprimtarisë së tij, si dhe në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “Infosoft Office” SHPK, sipas ekstraktit historik si më sipër cituar rezulton, se përfshihet objekti i prokurimit.

Sa më lart pretendimi i i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “AN&RA” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar,” me nr. REF-35374-01-15-2025, me objekt: “Loti II: “Blerje materiale për “Art dhe Zeje”, me fond limit 25,935,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 16.01.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësim të ofertës së operatorit ekonomik” Infosoft Office” SHPK në përputhje me konstatimet në këtë vendim.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AN&RA” SHPK .
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

